



VENDIM

Nr. 86, Datë 09.06.2016

MBI

KËRKESËN E SHOQËRISË “HERA” SH.P.K PËR SHTYRJEN E AFATEVE TE LICENSES NR. 49, SERIA NPM07 “PËR NDERTIM, INSTALIM, SHFRYTEZIMIN DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALE ELEKTRIKE, (PROJEKTI KAPPET)”, TË DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S ME NR. 61, DATË 02.11.2007, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, gërma “a” të Ligjit 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë të Elektrike”, Nenit 5 dhe 6, të “Rregullores për Procedurat e Heqjes së një Liçense, neneve 16 pika 2 dhe 18 te Rregullave te praktikës dhe procedurave te ERE miratuar me vendimin nr 21, datë 18.03.2009, i ndryshuar gërma, “a”, “d”, “e” të Vendimit nr. 61, date 02.11.2007 të Bordit të ERE-s, pikës 1.2; 1.6 dhe 1.7 të kushteve te licensës nr. 49, seria NPM07P “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale elektrike,(Projekti Kappet)”, te dhënë me Vendimin e Bordit te ERE-s me Nr. 61, date 02.11.2007, i ndryshuar, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 09.06.2016, mbasi shqyrtoi informacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit te Tregut, për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE ne licencen e shoqërisë “HERA” sh.p.k,

Konstatohet se:

- Duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e investimit dhe me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e ndërtimit të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë ERE ka pranuar kërkesat e shoqërisë “HERA” sh.p.k në lidhje me shtyrjen e afateve për realizimin e projektit duke përfshirë këtu edhe kolaudimin e veprës.
- ERE ka miratuar shtyrjen e afateve me vendimet :
 - Vendimin e Bordit te Komisionerëve Nr. 56, datë 25.08.2010,
 - Vendimin e Bordit te Komisionerëve Nr. 136, datë 15.11.2013,

- Me shkresën me Nr. 89 Prot., date 22.10.2014, shoqëria “HERA” sh.p.k, ka paraqitur një kërkesë tjetër për shtyrjen me 24 muaj të afateve të licensës së ndërtimit të dhënë me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me Nr. 61, date 25.11.2007, i ndryshuar së fundmi me vendimin Nr. 136, date 15.11.2013.
- Mospërmbushja e pikës 4 të vendimit nr. 61 datë 25.11.2007, i ndryshuar e bën licencën të pavlefshme.
- Kur nuk përmbushen kushtet thelbësore të licencës së dhënë, sipas ligjit nr.43/2015 "Për sektorin e energjise elektrike", ERE me iniciativën e vetë mund të heqë licencën.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

- Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “HERA” sh.p.k, për zgjatjen e afatit të licensës nr. 49, seria NPM07P “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale elektrike,(Projekti Kappet)”, të dhënë me Vendimin e Bordit të ERE-s me Nr. 61, date 02.11.2007, i ndryshuar.
- Fillimin e procedurave për heqjen e licencës së shoqërisë “HERA” sh.p.k, nr. 49, seria NPM07P.
- Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI